

**VENDIM**  
**Nr. 714, datë 26.11.2025**

**PËR SHPALLJEN E DISA ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E**  
**EKONOMISË MALORE NË BASHKINË SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, “Për paketën e maleve”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpalljen “Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore” në territorin e Bashkisë Shkodër, si më poshtë vijon:

a) zona nr. 1, Njësia Administrative Shalë, fshati Theth, zona kadastrale 3597, me sipërfaqe 2286.3 (dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë tre) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH të paraqitur mbi ortofoto;

b) zona nr. 2, Njësia Administrative Shalë, fshati Nderlysaj, zona kadastrale 2771, me sipërfaqe 425.9 (katërqind e njëzet e pesë pikë nëntë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH të paraqitur mbi ortofoto;

c) zona nr. 3, Njësia Administrative Guri i Zi, fshati Rragam, zona kadastrale 3148, me sipërfaqe 474.5 (katërqind e shtatëdhjetë e katër pikë pesë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH të paraqitur mbi ortofoto;

ç) zona nr. 4, Njësia Administrative Guri i Zi, fshati Sheldi, zona kadastrale 3329, me sipërfaqe 388 (treqind e tetëdhjetë e tetë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH të paraqitur mbi ortofoto;

d) zona nr. 5, Guri i Zi, fshatrat Mazrek–Shpor, zona kadastrale 2624, me sipërfaqe 845.8 (tetëqind e dyzet e pesë pikë tetë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH të paraqitur mbi ortofoto.

2. Shtrirja, kufijtë, pikat e hyrjes dhe të daljes së kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, sipas sistemit KRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e aktiviteteve, që do të zhvillohen në këtë zonë, janë:

a) të zhvillimit ekonomik;


b) industriale;

c) turistike.


4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**



| Grupi i Punës: |            |             |             |              |            |              |
|----------------|------------|-------------|-------------|--------------|------------|--------------|
| Alban Preka    | Rasel Teli | Arban Gjoka | Jozeq Ndoci | Renato Lumçi | Bekim Mema | Mikel Kapsaj |



Grupi i Punës:  
Alban Preka    Rasel Teli    Arban Gjoka    Jozef Ndoci    Renato Lumçi    Bekim Mema    Mikel Kapsaj



Alban Preka

Rasel Teli


Arban Gjoka

Grupi i Punës:  
Jozef Ndoci

Renato Lumçi

Bekim Mema

Vitor Hila





Alban Preka

Rasel Teli

Arban Gjoka

Grupi i Punës:  
Jozef Ndoci

Renato Lumçi

Bekim Mema

Vitor Hila